



Në bazë të nenit 12, 14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale Nr-03/L-040, nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe nenit 8 dhe 9 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr. 04 L-144, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me datë 2 prill 2013, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave të ankandit të shpallur për gjahishte në Rahovec

Neni 1

Me këtë vendim formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të gjahishtes Komunën e Rahoveci.

Neni 2

Komisioni vlerësues përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve në përbërje si vijon:

1. Feim Fetoshi, nga Kuvendi i Komunës, anëtar
2. Elhami Zhuniqi, nga Kuvendi i Komunës, anëtar
3. Kujtim Popaj, nga Kuvendi i Komunës, anëtar
4. Fatmir Iska, nga ekzekutivi i Komunës, anëtar
5. Musa Cena, nga ekzekutivi i Komunës, anëtar
6. Bjondina Ramaj, nga ekzekutivi i Komunës, anëtare
7. Naim Cahanaj, nga shoqëria civile – KDI, anëtar.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit: Anëtarët e Komisionit duhet të jenë prezent në ankand dhe në hapjen publike të ofertave, duhet të sigurohen që ofertat të jenë të mbyllura dhe të protokolluara para hapjes dhe komisioni është autoritet për vlerësimin final të ofertave ekonomikisht më të favorshme, gjithmonë në pajtim me kriteret e përcaktuara në

ankand publik për shprehjet e interesit, konform Ligjit Nr. 04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Rahovecit që të përkrah dhe mbështet Komisionin për vlerësimin e ofertave, gjatë zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës afatshkurtër.

Neni 5

Komisioni vlerësues pas përfundimit të procedurës së vlerësimit është i obliguar të përpiloj procesverbalin dhe t'i dërgoj Kryetarit të Komunës për aprovim ofertës së përzgjedhur ekonomikisht më të favorshme.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të publikohet në Web faqen dhe Tabelën e shpalljeve të Komunës së Rahovecit.

01 Nr. 9876
Rahovec, 2 prill 2013

Kuvendi i Komunës së Rahovecit

Kryesuesi i Kuvendit

Xhemali Haxhimustafa